



AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202001513/2

Tiranë ___/___/2020

Lënda : *Kërkesë për fillimin e procedurës administrative dhe marrjen e masës disiplinore ndaj Shefit të Komisarariatit të Policisë Shkodër.*

**DREJTORISË VENDORE TË POLICISË
Shkodër**

**Për dijeni : Komisarariatit të Policisë
Shkodër**

Me shkresën nr. K2/V18-2 prot., datë 05.12.2019 drejtuar Komisarariatit të Policisë Shkodër e kemi vënë në dijeni se në Institucionin e Avokatit të Popullit ka bërë ankesë shtetësja V. C. . Ankuesja shkruan se që prej 6 vitesh ndodhet në dyert e Komisariateve të Policisë Shkodër sepse dhunohet nga ish bashkëshorti P. Th.. Sipas saj, për këtë problem nga Gjykata e Shkallës së Parë Shkodër është lëshuar një urdhër mbrojtjeje por ai është shkelur nga ish bashkëshorti i saj. Ndonëse ka bërë kallëzim në Komisariatin e Policisë Shkodër, nuk ka patur asnjë reagim për vënien e tij para përgjegjësisë ligjore. Gjithashtu në këtë ankesë ajo ka ngritur edhe një shqetësim lidhur me kontrollin e banesës dhe shoqërimin e djemve të saj nga punonjësit e Komisarariatit të Policisë Shkodër sa herë që ndodhin ngjarje kriminale në këtë qytet. Ndërkohë ajo ka ngritur edhe pretendimin për mos reagimin e strukturave të policisë ndaj kërcënimeve që i janë bërë asaj nëpërmjet aplikacionit "Messenger" nga një adresë false.

Me shkresat nr. 6588/1 prot., datë 10.01.2020 dhe nr. 675 prot., datë 11.03.2020 ndërmjet të tjerave ky komisarariat informoi se, specialisti i policisë së zonës dhe specialisti për hetimin e krimeve kanë shkuar disa herë në banesën e ankueses në fshatin Grudë e Re të Njësisë Administrative Rrethina, Bashkia Shkodër, por as ajo dhe as ish bashkëshorti i saj nuk janë gjetur në banesë. Nga informacionet e marra prej tyre rezultoi se ata të dy prej kohësh kanë ikur në Tiranë, por nuk dihet adresa e saktë. Gjithashtu ky komisarariat na informoi se pretendimet e ngritura në ankesën e saj nuk qëndrojnë dhe se nga verifikimet e bëra rezultoi se ankuesja nuk ka urdhër mbrojtjeje. Përveç sa më sipër, në përgjigjen e dërguar shkruhej se bashkëlidhur ishte edhe fotokopja e raportit të shërbimit të përpiluar nga specialisti i policisë së rendit, por në fakt ky dokument nuk na është dërguar.

Përveç sa më sipër ju sqarojmë se, së bashku me ankesën ankuesja na ka dërguar edhe fotokopjen e përgjigjes që ka marrë nga Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme (SHÇBA) me shkresën nr. V-12/1 prot., datë 27.06.2019. Nga përmbajtja e kësaj përgjigjeje rezultojnë se nga ana e SHÇBA-së janë bërë bërë verifikime lidhur me pretendimet e saj si në Komisariatin e Policisë Shkodër ashtu edhe në Komisariatin e Policisë nr. 3 Tiranë.

Kallëzimin ndaj shtetasit P. Th. për veprën penale të dhunës në familje ankuesja e ka bërë në Komisariatin e Policisë Shkodër në datën 23.09.2013. Nga strukturat e këtij komisarati janë kryer veprimet procedurale dhe materialet i janë referuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër. Gjithashtu me shkresën nr. 3450 prot., datë 24.09.2013, me kërkesën e saj, Komisarati i Policisë Shkodër i ka dërguar Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, kërkesë-padinë për lëshimin e Urdhrit të Menjehershëm të Mbrojtjes. Me vendimin nr. 303, datë 25.09.2013 Gjykata ka pranuar kërkesë-padinë e saj. Në datën 30.09.2013 strukturat e policisë i kanë bërë njohjen shtetasit P. Th. me këtë vendim, i cili ka nënshkruar dhe ka bërë shënimin se nuk ka qënë dakord.

Pra, sikurse rezultojnë nga përgjigjja dërguar ankueses nga SHÇBA, në kundërshtim me atë që na informoi Komisarati i Policisë Shkodër, ankuesja ka patur urdhër mbrojtjeje. Ndërsa lidhur me pretendimet e saj, për kontroll dhe shoqërimin e djemve për çdo ngjarje që ndodh në qytet, nga punonjësit e Komisariatit të Policisë Shkodër rezultojnë që vetëm në një rast, shtetasi A. Th. është shoqëruar në këtë organ në kuadër të dokumentimit të një veprë penale për shkak të njohjes së tij me autorët e dyshuar të kësaj veprë.

Për këto arsye me shkresën dhe nr. K2/V18-6 prot., datë 05.02.2020 drejtuar Komisariatit të Policisë Shkodër i kërkuam të riverifikonte këtë ankesë dhe të na dërgonte një informacion shtesë lidhur me pretendimet e ngritura nga ankuesja për shkeljen e urdhrit të mbrojtjes nga ish bashkëshorti i saj. Gjithashtu i kërkuam edhe dërgimin e fotokopjes së raportit të shërbimit të përpiluar nga specialisti i policisë së rendit lidhur me verifikimet e bëra në banesën e ankueses për këtë ankesë.

Ndonëse afati ligjor për dërgimin e informacionit dhe të dokumentit të kërkuar kaloi, ato nuk na u dërguan. Me shkresën nr. K2/V18-7 prot., datë 10.06.2020 i rikërkuam këtij komisarati dërgimin e informacionit dhe dokumentit të cituara më sipër. Bazuar në nenin 19, paragrafin e fundit të këtij neni ku parashikohet se: *"Avokati i Popullit ka të drejtë të caktojë një afat për kryerjen e veprimeve të mësipërme"*, i kërkuam dërgimin e tyre brenda 5 ditëve nga data e mbërritjes së kërkesës tonë. Por edhe pas dërgimit të kërkesës së dytë me të njëjtin objekt, përsëri ky komisarati nuk na dërgoi informacionin shtesë dhe fotokopjen e raportit të shërbimit të kërkuara nga ana jonë.

Sjellim në vëmendje se moskthimi i përgjigjeve të kërkuara nga Institucioni i Avokatit të Popullit është një nga rastet tipike të mosbashkëpunimit të një funksionari të administratës publike me institucionin tonë.

Ky qëndrim i mbajtur nga drejtuesi i Komisariatit të Policisë Shkodër me institucionin tonë ka sjellë pengesë në kryerjen e misionit kushtetues e ligjor të Avokatit të Popullit për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të shtetasve dhe në kthimin në kohë të përgjigjes ankueses. Ndërkohë kjo sjellje, cenon rëndë marrëdhëniet tona institucionale, si dhe imazhin e institucionit të Avokatit të Popullit në publik.

Për këto arsye, bazuar në nenin 22/1 të ligjit "Për Avokatin e Popullit" ku parashikohet se: *"Refuzimi për të bashkëpunuar me Avokatin e Popullit nga nëpunësi civil, funksionari ose autoriteti publik përbën shkak që Avokati i Popullit të kërkojë nga autoriteti kompetent fillimin e procedurës administrative dhe marrjen e masave disiplinore deri në largimin nga puna ose nga shërbimi civil"*,

KËRKOJMË:

Fillimin e procedurës administrative (ecurisë disiplinore) dhe marrjen e masës disiplinore ndaj Shefit të Komisarariatit të Policisë Shkodër i cili nuk ka kthyer përgjigje kërkesave të Institucionit të Avokatit të Popullit për dërgimin e informacionit dhe dokumentit të kërkuar.

Për qëndrimin që do të mbani ndaj kësaj kërkesë dhe masën disiplinore që do të merrni, na vini në dijeni brenda afatit ligjor prej 30 ditësh të parashikuar në nenin 22 të ligjit “Për Avokatin e Popullit”.

Bashkëlidhur po ju dërgojmë fotokopje të shkresave të cituara më sipër respektivisht me nr. K2/V18-2 prot., datë 05.12.2019, nr. K2/V18-2 prot., datë 05.12.2019 dhe nr. K2/V18-7 prot., datë 10.06.2020.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONERI

Ermonela Ruspi

Konceptoi: S. Nushi